



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL PËR VITIN 2020

Prishtinë, qershor 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Elbert Krasniqi, Ministër

Adresa: Ish ndërtesa Rilindja, kati 11,12,13 , Prishtinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MAPL kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Ministri është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Ministri është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraparak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditjet ishte 1,023,373€ prej tyre ishin shpenzuar 969,397€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit/planifikimit ishte 123 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 119. Gjatë vitit 2020 nuk kishte të punësuar të rinj. Kemi testuar 30 mostra për teste substanciale në vlerë 17,937€, si dhe katër mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A1 - Mungesë e zyrtarit të pasurisë

Gjetja Sipas nenit 4 paragrafi 7 të Rregullores MF – nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore- Organizata buxhetore cakton një Zyrtar të Pasurisë. Aty ku është e arsyeshme, organizata buxhetore mund të kenë më tepër se një Zyrtar të Pasurisë. Detyrat e Zyrtarit të Pasurisë mund të jenë vetëm një pjesë e punës së plotë në organizatë buxhetore.

Pozita për zyrtarë të pasurisë nuk ishte plotësuar që nga viti 2018, MAPL me dt.01.01.2020 kishte hapur konkurs të brendshëm për këtë pozitë mirëpo ky konkurs ishte anuluar për shkak se kandidatët nuk i kishin përmbushur kriteret e kërkuara me konkurs.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Mos plotësimi apo vonesat në plotësimin e pozitave të caktuara, rrisin rrezikun që aktivitetet operative dhe menaxhuese të MAPL-së të mos kryhen me profesionalizëm, me kohë, në mënyrë cilësore apo edhe të mos kryhen fare.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura që të eliminohen arsyet apo pengesat e plotësimit të pozitës së zyrtarit të pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 716,092€, prej tyre ishin shpenzuar 121,184€. Kemi testuar 5 mostra për teste substanciale në vlerë 18,265€ si dhe 3 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B1 - Avancet e pambyllura nga vitet paraprake

Gjetja Në bazë të rregullës financiare nr.01/2013 MF- shpenzimi i parave publike dhe udhëzimit administrativ për udhëtime zyrtare nr. MShP 2004/7, avancet për udhëtime zyrtare duhet të mbyllën dhe shumat e pashpenzuara duhet të kthehen në llogarinë bankare brenda 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.

MAPL, në nenin 20 në Raportin Vjetor Financiar (RVF), kishte paraqitur vlerën prej 5,945€, avance të paarsyetuara për udhëtime zyrtare nga vitet paraprake 2010-2014. MAPL kishte dëshmi se avancet ishin mbyllur, mirëpo në SIMFK ato ende figurojnë të hapura. MAPL kishte bërë kërkesë në Thesar për t'i korrigjuar avancet e mëhershme duke dërguar dokumentacionin e duhur dhe ishte në pritje të korrigjimit të pjesës së mbetur të avanceve të hapura nga Thesari. Çështja e njëjtë ishte raportuar edhe në raportin tonë të auditimit për vitin 2019.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos koordinimit të mirë në mes të zyrtarëve përgjegjës të MAPL-së dhe Thesarit.

Ndikimi Vonesa në mbylljen e avanceve ndikon në mos evitimin e gabimeve në llogarinë e avanceve, dhe pasqyron shpenzime të pambyllura duke bërë që kjo llogari të figurojë e hapur në vazhdimësi. Po ashtu, informatat e prezantuara në PFV nuk prezantojnë gjendjen reale të avanceve të ministrisë.

Rekomandimi B1 Ministri në bashkëpunim me Thesarin duhet të siguroj se janë marrë masat konkrete për mbylljen e avanceve të hapura bazuar në dëshmitë e siguruar nga MAPL-ja, në mënyrë që të evitohet mbivlerësimi i tyre në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 3,954,382€, pasurive jokatitale është 35,822€, si dhe e stoqeve 4,110€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 3,454,677€.

Çështja A2 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja

Neni 12 i rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo-financiare në OB, thekson se - Organizatat mund të blejnë dhe ndërtojnë pasuri përmes bashkëfinancimit dhe deri në momentin e pranimin të pasurisë jofinanciare, ato do të regjistrojnë në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jofinanciare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e pranimin nga ana e OB, atëherë kategoria e investimeve në vijim mbyllet edhe në regjistrat e OB-së pranuese dhe OB-së bashkë-financuese. Pasuria më pas regjistrohet në regjistrin e pasurisë së OB-së pranuese.

Nga testimet tona kemi evidentuar se tetë (8) projekte përmes bashkëfinancimit në vlerë totale 587,329€ edhe pse ishin përfunduar dhe ishte bërë pranimi teknik i tyre nga komisionet e formuara nga komunat përkatëse, ato ende figuronin si investime në vijim në regjistrin e pasurisë së MAPL-së.

Kjo kishte ardhur si rezultat i mungesës së komunikimit dhe koordinimit të mjaftueshëm të menaxherëve të kontratave me zyrtarët e pasurisë të të dy OB të cilët janë përgjegjës për evidentim dhe regjistrim të pasurive. Edhe pse ZKF kishte kontaktuar me email disa komuna mirëpo ato nuk i ishin përgjigjur emailit.

Ndikimi

Mbajtja e projekteve të përfunduara në regjistrin e pasurisë si investime në vijim jep një pasqyrë jo të saktë të pasurive në posedim, si dhe ndikon në mbivlerësim të pasurive dhe krijon një çorientim për palë të ndryshme të interesit apo për shfrytëzues të raportit financiar.

Rekomandimi A2

Ministri në bashkëpunim me departamentin e monitorimit duhet të sigurojnë një komunikim të mirëfilltë dhe në kohë në mes të zyrtarëve përgjegjës në mënyrë që regjistri i pasurive të azhurnohet me kohë, duke i regjistruar dhe fshirë të gjitha pasuritë sipas kërkesave të rregullores.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre zyrtarë - Drejtori i NjAB-së dhe dy auditorë. NjAB-i bazuar në planin strategjik (2019-2021) kishte hartuar Planin Vjetor për vitin 2020 dhe deri në fund të vitit kishte finalizuar gjashtë raporte të Auditimit, aq sa ishin planifikuar. Nga këto raporte kanë rezultuar 14 rekomandime, tri prej tyre janë zbatuar, tri janë në proces të zbatimit dhe tetë rekomandime kanë mbetur të pazbatuara. Lidhur me funksionimin e NJAB-së, kemi trajtuar çështjen si në vijim:

Çështja A3 - Mos funksionimi i komitetit të auditimit

Gjetja Udhëzimi administrativ MF - NR. 01 / 2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, neni 4 "1. Çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësinë e auditimit të brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit.

Komiteti i Auditimit nuk ishte funksional gjatë vitit 2020 duke pamundësuar përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, shqyrtimin e raporteve dhe dhënien e mbështetjes Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Sipas Ministrisë kryesuesja e Komitetit të Auditimit kishte dhënë dorëheqje, edhe pse kërkesa për zëvendësim të kryesueses ishte bërë, mirëpo kjo kërkesë ishte neglizhuar nga menaxhmenti.

Ndikimi Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit rezulton me mungesë të monitorimit të punës të NjAB për të ofruar mbështetje menaxhmentit në vendimmarrje dhe të sigurojë që rekomandimet e auditimit janë trajtuar dhe zbatuar.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të siguroj funksionimin e Komitetit të Auditimit, i cili duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

“Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	4,630,312	3,958,349	2,931,994	4,760,820	4,834,107
Grante Qeveritare – Buxheti	4,630,312	3,318,128	2,849,013	3,714,414	4,676,584
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	919,787	0
Donacionet e jashtme	0	640,222	82,982	126,619	157,523

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar në total ishte zvogëluar për 671,963€. MAPL gjatë vitit kishte pranuar grante nga donatorët në vlerë 640,222€, ndërsa me vendime të qeverisë për ndarje dhe kursime buxhetore, buxheti i saj ishte zvogëluar për 1,312,184€.

Në vitin 2020, MAPL ka shpenzuar 74% të buxhetit final ose 2,931,994€ me një ulje prej 17% krahasuar me vitin 2019. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	4,630,312	3,958,349	2,931,994	4,760,820	4,834,107
Pagat dhe mëditjet	1,047,757	1,023,373	969,397	1,022,588	1,018,893
Mallrat dhe shërbimet	338,708	716,092	121,183	254,288	242,033
Komunalitë	15,500	9,588	5,140	8,394	12,547
Subvencionet dhe transferet	0	0	0	0	46,815
Investimet Kapitale	3,228,347	2,209,296	1,836,273	3,475,551	3,513,819

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 24,384€, ky zvogëlim vjen si rezultat i shkurtimeve buxhetore për 133,659€. Gjithashtu kishte një rritje nga

grantet të donatorëve për 109,276€. Buxheti final ishte realizuar 95%;


- Buxheti final për mallra dhe shërbime kishte rritje në krahasim me buxhetin fillestar për 377,384€, kjo rritje ishte si rezultat i granteve të donatorëve në vlerë 527,384€. Mirëpo me shkurtime buxhetore ishin zvogëluar për 120,000€, si dhe me vendimin e Qeverisë nr.09/50 të datës 21.12.2020 nga ky buxhet në emër të kursimeve janë marrë 30,000€. Përkundër kësaj rritje, realizimi i buxhetit final është shumë i ulët vetëm 17 % si rezultat i mos shpenzimeve të grantit nga Banka Botërore për kategorinë mallra dhe shërbime dhe kategorinë e shpenzimeve komunale.

- Tek shpenzimet komunale, buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 5,912€. Në këtë ka ndikuar zvogëlimi prej 9,474€ si rezultat i shkurtimeve buxhetore dhe kursimeve përderisa në anën tjetër kishte një rritje prej 3,562€ nga grantet e donatorëve. Realizimi ishte 54% e buxhetit final; dhe


- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,019,051 €. Me rishikim të buxhetit vlera fillestare ka një rritje të buxhetit prej 465,733€. Ndërsa me vendime të Qeverisë për kursime buxhetore (vendimi nr.01/46 datë: 25.11.2020 dhe vendimi nr.09/50 datë: 21.12.2020) buxheti ishte zvogëluar për 1,484,784€.

MAPL për menaxhimin e pandemisë Covid-19 kishte shpenzuar 232€, nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 ka rezultuar në katër rekomandime. MAPL kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, tri rekomandime janë zbatuar dhe një nuk është adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak



Tabela 3 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Mallrat dhe shërbimet	Ministri në bashkëpunim me Thesarin të siguroj se janë marrë masat konkrete për mbylljen e avanceve të hapura bazuar në dëshmitë e siguruar nga MAPLja, në mënyrë që të evitohet mbivlerësimi i tyre në RVF.	Nuk janë ndërmarra veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Mallrat dhe shërbimet	Ministri të siguroj se marrëveshjet e mirëkuptimit të cilat të lidhen për financimin e organizatave tjera buxhetore të bëhen brenda kompetencave të parapara ligjore dhe përmes kategorive ekonomike në të cilat buxhetohen fonde për këto qëllime. Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve, të respektohen në plotësi kushtet e saj në mënyrë që të evitohen pagesat e parregullta.	Janë ndërmarra veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi	I zbatuar
3.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se para financimit të të gjitha projekteve kapitale të komunave, do të caktohen kritere specifike, të qarta, të drejta dhe transparente siç parashihet me ligjin për	Janë ndërmarra veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi	I zbatuar

		ndarjet buxhetore.		
4.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj se pagesat e realizuara për projektet përmes bashkëfinancimit me komunat, të cilat regjistrohen si investime në vijim në regjistrin e pasurive të ministrisë, nuk fshihen nga regjistrat, pa u siguruar se është bërë marrëveshje transferi, janë pranuar teknikisht dhe mund të regjistrohen në regjistër të pasurisë së komunës përfituese	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi	I zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura që të eliminohen arsyet apo pengesat e plotësimit të pozitës së zyrtarit të pasurisë.
2.	Mallrat dhe shërbimet	Ministri në bashkëpunim me Thesarin të siguroj se janë marrë masat konkrete për mbylljen e avanceve të hapura bazuar në dëshmitë e siguruara nga MAPLja, në mënyrë që të evitohet mbivlerësimi i tyre në RVF.
3.	Pasuritë	Ministri në bashkëpunim me departamentin e monitorimit duhet të sigurojnë një komunikim të mirëfilltë dhe në kohë në mes të zyrtarëve përgjegjës në mënyrë që regjistri i pasurive të azhurnohet me kohë, duke i regjistruar dhe fshirë të gjitha pasuritë sipas kërkesave të rregullores.
4.	Auditimi Brendshëm	Ministri duhet të siguroj funksionimin e Komitetit të Auditimit, i cili duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Arian Haxha, Udhëheqës i Auditimit



Shqiponja Krasniqi, Udhëheqëse e ekipit



Luljeta Sylaj, Anëtare e ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyren e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkronje, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për vitin 2020 (shë tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Elbert Kraçiqi

Ministër-Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Data: 16 qershor 2021

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet. Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionit i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- 1 Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- 2 Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- 3 Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja

Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura

Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Rregullimi i rrugës dhe rrëshqitjeve të dheut ne aksin rrugor ura e Bërnjakut shkolla fillore "Petar Kociç" në fshatin Bërnjak-komuna e Zubin Potokut me vlerë 39,922,94€, Rregullimi i kanalizimit fekal dhe asfaltimi i rrugëve në lagjen e Porodinit- Komuna e Gjilanit me vlerë 176,420,24€, Rregullimi i Parkut dhe këndit të lojërave në zonën rekreativo-sportive- Komuna Ferizaj me vlerë 50,094,90€, Shtigjet e ecjes dhe shtigjet e biçikletave në Lipjan- komuna e Lipjanit me vlerë 81,672.30€, Rregullimi i platosë në qendër të vendbanimit të Leposaviq - komuna e Leposaviqit në vlerë 29,172€, Ndërtimi i një parkingut për administratën e komunës së Ranillugut - komuna e Ranillugut me vlerë 30,000€, Renovimi i qendrës kulturore në Partesh dhe rregullimi i platosë para ndërtesës - komuna e Parteshit me vlerë 30,000€, "Rregullimi i sheshit në qendër të Vitisë" me vlerë 150,047€, ishte pranuar teknikisht me dt.16.12.2020.

Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.